



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit
P-09
Prishtinë, më 19 janar 2015, ora 17:00

PROCESVERBAL

**I SEANCËS SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 19 JANAR 2015**

Seancën e kryesoi Kadri VESELI, kryetar i Kuvendit, ndërsa i ndihmoi Xhavit HALITI, nënkryetar.

Kryetari i hapi punimet e seancës së jashtëzakonshme dhe i njoftoi deputetët se kjo seancë është thirrur me kërkesë të kryeministri i Republikës së Kosovës z. Isa Mustafa, bazuar në nenin 69.4 të Kushtetutës së Kosovës.

Ai tha se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, në mbledhjen e mbajtur më 19 janar 2015 i ka propozuar Kuvendit që shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-035 për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre të bëhet me procedurë të përshpejtuar - shmangie nga Rregullorja, sipas nenit 84 të Rregullores së Kuvendit.

Gjithashtu, kryetari i njoftoi deputetët se edhe Komisioni FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në mbledhjen e mbajtur më 19 janar 2015, e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe ka rekomanduar që shqyrtimi i tij në seancë të bëhet sipas procedurës së përshpejtuar.

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Komisionit FunkSIONAL që ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin e komisionit.

Kryetari i Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, Muhamet Mustafa, e arsyetoi raportin e komisionit dhe i propozoi Kuvendit që, bazuar në nenin 84 të Rregullores së Kuvendit, të bëjë shmangie nga Rregullorja për shqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-035 për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre.

Në lidhje me propozimin e paraqitur nga kryetari i Komisionit FunkSIONAL, Muhamet Mustafa, në emër grupeve parlamentare u deklaruan deputetët: Adem Grabovci, në emër të GP PDK; Ismet Beqiri, në emër të GP LDK; Visar Ymeri, në emër të GP VV; Donika Kadaj-Bujupi, në emër të GP AAK; Sasha Milosavljeviq, në emër të GP LS; Jakup Krasniqi, në emër të GP “Nisma” dhe Myfera Shinik, në emër të GP “6+”, diskutimi i të cilëve është dhënë i plotë në transkript.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim propozimin e paraqitur nga deputeti Muhamet Mustafa.

Rezultati i votimit ishte:

Për ----- 76,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-008 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-035 për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre të bëhet me procedurë të përsheptuar - shmangie nga Rregullorja - sipas nenit 84 Rregullores së Kuvendit për afatet procedurale të parapara për shqyrtimin e projektligjit.
2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-035 për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre të bëhet në seancën plenare më 19 janar 2015.
3. Pas miratimit në parim, Komisioni FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri dhe Komisionet e përhershme e shqyrtojnë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-035 për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre dhe Kuvendit ia paraqesin raportet me rekomandime.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-035 për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre

Para se të fillohet me shqyrtimin në parim të këtij projektligji, deputeti Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, propozoi që edhe shqyrtimi i dytë i këtij projektligjit të bëhet me shmangie nga Rregullorja e Kuvendit, sipas nenit 84 të Rregullores së Kuvendit.

Në lidhje me propozimin e paraqitur nga deputeti Muhamet Mustafa, në emër grupeve parlamentare u deklaruan deputetët: Adem Grabovci, në emër të GP PDK; Ismet Beqiri, në emër të GP LDK; Sasha Milosavljeviq, në emër të GP LS dhe Myfera Shinik, në emër të GP “6+”, fjala e të cilëve është dhënë e plotë në transkript.

Më pas, kryetari e hodhi në votim propozimin e kryetarit të Komisionit FunkSIONAL, Muhamet Mustafa.

Rezultati i votimit ishte:

Për ----- 67,
Kundër ----- 2,
Abstenime ----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-008 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-035 për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre të bëhet me procedurë të përsheptuar - shmangie nga dispozitat e Rregullores së Kuvendit, sipas nenit 84 të Rregullores për afatet procedurale të parapara për shqyrtimin e dytë të projektligjit.

2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-035 për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre të bëhet në seancën plenare të radhës, më 19 janar 2015, në orën 20:00.

Pastaj, kryetari procedoi me shqyrtimin e parë të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-035 për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre.

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-035 për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre.

Kryeministri i Kosovës, Isa Mustafa, tha se ky projektligj ka për qëllim përcaktimin e rregullave dhe procedurave për riorganizimin e borxheve të ndërmarrjeve të caktuara në pronësi shoqërore.

Rregullat dhe procedurat e përcaktuara në këtë projektligj do të zbatohen për riorganizimin dhe likuidimin e çdo ndërmarrjeje për të cilën është dorëzuar një kërkesë për riorganizim nga Agjencia e Privatizimit, ose paraardhësja e saj në Dhomën e Posaçme.

Në vazhdim, kryeministri e paraqiti strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji.

Në fund, kryeministri i ftoi deputetët që ta miratojnë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre.

Lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre diskutuan këta deputetë: Muhamet Mustafa, në emër të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri dhe në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Besim Beqaj, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, si dhe Bekim Haxhiu, Fatmir Rexhepi, Margarita Kadriu-Ukelli, Ramiz Kelmendi, Sadri Ferati, Sabri Hamiti, Shaip Muja dhe ministri Hajredin Kuçi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-035 për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre.

Rezultati i votimit ishte:

Për ----- 64,
Kundër ----- 4,
Abstenime ----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-035 për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, si Komision Funkcional dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime në seancën tjetër të radhës, e cila do të mbahet më 19 janar 2015, në orën 20:00.

Kryetari i mbylli punimet e kësaj seance në orën 18:55 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale